

HARTIMI I KURRIKULE SE TRAJNIMIT

Shtojca A

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR HARTIMIN E KURRIKULËS SË NJË MODULI TRAJNIMI

(Aspektet bazë - version i shkurtuar)

PRODUKTI “Kurrikula e trajnimit” synon rritjen e kapaciteteve qeverisëse, administrative dhe profesionale, përmes marrjes së njohurive të aplikueshme në vendin e punës, përfshirë rastet studimore nga praktika në punë.

Kurrikula e trajnimit përbëhet nga këto dokumenta:

- a. Materiali Didaktik
- b. Materiali Teorik
- c. Banka e Pyetjeve

a. Materiali Didaktik

Materiali didaktik sqaron: **qëllimin e të mësuarit** - për çfarë duhet të dhënë mësimi (teach) dhe për çfarë duhet nxënë (learn); **aspektin e përmbajtjes** - çfarë duhet dhënë si mësım/dije (teach) dhe çfarë duhet nxënë (learn); **aspektet e transmetimit të dijes dhe ato të të nxënıt** - si të japim mësım (teach) dhe si të nxëmë (learn).

Materiali didak përbëhet nga:

- i. **Tabela përmbledhëse e programit të trajnimit**, e cila duhet të hartohet sipas formatit bashkëlidhur në **Aneksin A.1** të këtij dokumenti, si:
 - Qëllimi dhe objektivat e trajnimit.
 - Sekuencat e aktiviteteve, përfshirë metodat e të nxënıt që do të përdoren gjatë çdo hapi të ditës së trajnimit (shiko **Aneksin A.2**).
 - Rezultatet e të nxënıt.
 - Mjetet didaktike për t’u përdorur gjatë aktivitetit si: flip chart, markera, etj
- ii. **Skedat individuale e çdo aktiviteti**. Për çdo aktivitet hartuesi i kurrikulës duhet të përgatisë skedën specifike, e cila duhet të ketë të gjitha detajet didaktike, përmbajtësore dhe organizative të shpjeguara qartë.

b. Materiali Teorik

Materiali teorik duhet:

- a. Të jetë një **përmbledhje e literaturës** bazë rreth çështjeve që do të mbulojë kurrikua e trajnimit.
- b. Të jetë në përputhje me kontekstin e **politikave të zhvillimit strategjik kombëtar dhe vendor**.
- c. Të reflektojë **ndryshimet më të fundit në legjislacionin** e zbatueshëm.
- d. Të jetë **jo më pak se 10 dhe jo më shumë se 15 faqe, për një ditë trajnim** të barasvlefshme me **6 orë në klasë**.

c. Banka e Pyetjeve

- a. Për çdo ditë trajnimi/**6 orë trajnim**, do të hartohen rreth **24** pyetje, që lidhe me kompetencat që trajnimi zhvillon tek pjesëmarrësit.
- b. Pyetjet do të jenë me zgjedhje të shumëfishtë dhe duhet të hidhen në një databazë sipas formatit në **Aneksin A.4** bashkëlidhur.

Aneksi A.1

Materiali didaktik

Fazat e Ciklit të Kolbit	Taksonomia e Bloomit	Shpërndarja e kohës sipas Kubit dhe Bloomit në %	Shpërndarja e kohës sipas Kolbit dhe Bloomit në minuta	Objektivat e të nxënit sipas Taksonomisë së Bloomit	Intervali kohor në 6 orë	Aktiviteti	Rezultatet e të nxënit	Mjetet e matjes së rezultateve	Logjistika
Përvoja e drejtpërdrejtë; Reflektimi mbi përvojën; Përgjithësimi i përvojës; Aplikimi	Mbaj mend	5%	20 minuta	Objektivi 1: Foljet që përdoren përkufizo, rendit, përshkruaj, dallo, rendit, emërto	10.00-10.20 Trajnim	20 minuta			
Përvoja e drejtpërdrejtë; Reflektimi mbi përvojën; Përgjithësimi i përvojës; Aplikimi	Kupto	6%	20 minuta	Objektivi 2: Foljet që përdoren shpjego, zgjero, jep përfundime, rishkruaj, përgjithëso	10.20-10.40 Trajnim	20 minuta			
Përvoja e drejtpërdrejtë; Reflektimi mbi përvojën; Përgjithësimi i përvojës; Aplikimi	Apliko	14%	50 minuta	Objektivi 3: Foljet që përdoren Ndrysho, njehso, provo, përgatit, prodho, lidh, përdor	10.40-11.30 Trajnim; 11.30-11.40 Pushim	50 minuta			
Përvoja e drejtpërdrejtë; Reflektimi mbi përvojën; Përgjithësimi i përvojës; Aplikimi	Analizo	17%	60 minuta	Objektivi 4: Foljet që përdoren dallo, seleksiono, planifiko	11.40-12.40 Trajnim	60 minuta			
Përvoja e drejtpërdrejtë; Reflektimi mbi përvojën; Përgjithësimi i përvojës; Aplikimi	Vlerëso	25%	90 minuta	Objektivi 5: Foljet që përdoren Konklado, kritiko, arsyeto	12.40-13.10 Trajnim; 13.10-14.00 Dreke; 14.00-14.15 Team building; 14.15-15.15 Trajnim	90 minuta			
Përvoja e drejtpërdrejtë; Reflektimi mbi përvojën; Përgjithësimi i përvojës; Aplikimi	Krijo	33%	120 minuta	Objektivi 6: Foljet që përdoren Prodho, krijo, perfomo, ndërto	15.15-15.30 Pushim; 15.30-17.35 Trajnim; 17.30-17.35 Mbyllje	120 minuta			

Aneksi A.2 Metodat e të nxënit

Metoda	Përshkrimi	Kur përdoret	Avantazhet	Kufizimet
Workshop	Të mësuarit rreth një problemi të identifikuar /diskutime me qëllim ndarjen e eksperiencave/ose gjetja e një zgjidhjeje.	Kur duhet të adresohet një problem. Kur duhet të zgjasim kohën e punës.	Bazohet në një qasje konsultative. Synon të angazhojë shumë njerëz.	Kërkon mirëkuptim nga individët. Duhet të menaxhohet dhe lehtësohet mirë.
Prezantime	Përgatitja e materialeve me anë të paraqitjes vizuale.	Zhvillon njohuritë, faktet dhe opinionet	Është e përshatshme për grupe të mëdhaja në numër.	Nuk ndihmon në zhvillimin e aftësive ose qëndrimeve.
Lojë me role (Role play)	Një metodë që krijon situatën ku pjesëmarrësit mund të zbatojnë në praktikë aftësitë dhe gjykimet në një atmosferë të sigurtë me feedback.	Për objektiva të cilat fokusohen në zhvillimin e aftësive dhe aftësive të komunikimit ndërpersonal.	Mundëson lidhjen e teorisë me praktikën. Përfshirje e gjerë të grupit të pjesëmarrësve.	Duhet të menaxhohet mirë.
Simulimi	Një metodë që risjell aspekte të një situatë reale, për një qëllim të caktuar mësimi.	Të mbështesë zhvillimin e aftësive për një situatë konkrete.	Pjesëmarrësit mund të shprehen lirshëm.	Mund të kërkojë shumë kohë për ta përgatitur dhe për ta zhvilluar.
Stuhi e mendimeve (Brainstorm)	Një diskutim i lirë me qëllim që çdo pjesëmarës të jetë kreativ në përgjigje dhe në shfaqjen e ideve.	Zgjidhjen e problemeve. Për mbledhjen e mendimeve kreative; ngroh situatën, krijon energji.	Shkakton një nivel të lartë pjesëmarrje.	Proçes jo kritik, mund të gjenerohen ide të papërshatshme.
Rast studimor (Case Study)	Një skenar i shkruar ose verbal, nga jeta reale ose hipotetik me pyetje që do të analizohen ose diskutohen.	Me qëllim rritjen e aftësive analitike apo vendimarrëse apo aftësive ndërpersonale në rastet kur punohet në grup.	Sjell realitetin në një ambient mësimi; mund të përfshijë emocione dhe qëndrime.	Varet nga cilësia e case study –it.
Demonstrimi	Një ilustrim fizik i një detyre, procedure , ose përdorimi i një pajisje.	Për trajnime me natyrë teknike Përgatitja për trajnimin në vendin e punës.	Pjesëmarrësit mund të vëzhgojnë para se ta zbatojnë.	Varet nga efektiviteti i demonstrimit aktual.
Diskutimi në grupe	Diskutim i gjerë/grupe të vogla për çështje të veçanta	Mbulon të gjitha fushat & në bashkëpunim me metodat e tjera.	Nivel i lartë pjesëmarrje. Mbështet mësimin individual, njohuritë, faktet, opinionet, qëndrimet.	Sa më i madh të jetë grupi, aq më pak mundësi pjesëmarrje ka individit. Ka nevojë për një person që ta drejtojë diskutimin.

Aneksi A.4
Databaza e pyetjeve
(me shembull)

Ref.	Moduli	Pyetja	Zgjedhja A	Zgjedhja B	Zgjedhja C	Zgjedhja D	Zgjedhja E	Pergjigjja e saktë	Ndarja e pyetjeve			Shkalla e vështirësisë së pyetjeve		
									Riprodhim konceptesh baze	Analitike/ Zbatuese	Sintezë/ Vlerësim	E lehtë	Mesatare	E vështirë
1	Vlerësimi i njohurive shtesë për inspektorët	Cilat nga këto funksione nuk kryen inspektorati qendror	<i>Bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore dhe vendore</i>	<i>Jep mendim këshillimor për programet vjetore të inspektimit</i>	<i>Jep mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore për çdo ministri</i>	<i>Mbikqyr ligjet sektoriale</i>		C	X				X	
2														
3														